AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

Eksplozivi në Shkodër/ Identifikohen dy autorët, pak më parë kishin vjedhur një motomjet në Shkodër

30/06/2023 09:52

Është zbardhur ngjarja e ndodhur mëngjesin e djeshëm në Shkodër ku dy shtetas vendosën lëndë eksplozive në garazhin e automjeteve të një shtetasi.

Policia ka bërë të mundur identifikimin e dy shtetasve që vendosën lëndë eksploxive në garazhin e automjeteve të një shtetasi.

Dy autorët S. M, 27 vjeç dhe Z. M., 27 vjeç janë larguar me një motomjet të vjedhur pak para ngjarjes, në qytetin e Shkodrës.

Ata janë shpallur në kërkim dhe autoritetet po punojnë për kapjen e tyre.

Shkodër

Zbardhet ngjarja e ndodhur në orët e para të mëngjesit të datës 29 qershor 2023, në lagjen "10 Korriku", ku shtetas të paidentifikuar vendosën lëndë eksplozive në garazhin e automjeteve të një shtetasi.

Falë veprimeve të shpejta dhe profesionale hetimore, u bë i mundur identifikimi i 2 shtetasve të dyshuar si autorë të vendosjes së lëndës eksplozive, si dhe u bë shpallja e tyre në kërkim.

Autorët e dyshuar, të shpallur në kërkim edhe më parë, për ngjarje të tjera kriminale.

Vijon puna intensive për kapjen e 2 shtetasve, të cilët janë larguar me një motomjet të vjedhur pak para ngjarjes, në qytetin e Shkodrës.

Strukturat hetimore te Komisariatit të Policisë Shkodër, në bashkëpunim me ato të DVP Shkodër dhe me Prokurorinë e Shkodrës, menjëherë pas ngjarjes së ndodhur në lagjen "10 Korriku", Shkodër, ku në derën e garazhit të automjeteve, në pronësi të shtetasit A. U., shpërtheu një sasi lënde plasëse (me pasoja vetëm dëme materiale), kanë organizuar punën me qëllim zbardhjen e kësaj ngjarjeje, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Falë veprimeve të shpejta dhe profesionale hetimore, administrimit të provave në vendngjarje, si dhe këqyrjes së kamerave në aksin rrugor përmes të cilit dyshohet se mund të ishin larguar autorët, u bë e mundur zbardhja e ngjarjes, si dhe identifikimi i 2 autorëve të dyshuar të saj. Gjithashtu, nga këto veprime dyshohet se 2 autorët e dyshuar janë larguar nga vendi i ngjarjes, me një motomjet të vjedhur në qytetin e Shkodrës, pak para ngjarjes.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, u shpallën në kërkim shtetasit S. M, 27 vjeç dhe Z. M., 27 vjeç, të shpallur në kërkim edhe më parë, për ngjarje të tjera kriminale të ndodhura në qytetin e Shkodrës.

Vijon puna intensive për kapjen e tyre.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Shkatërrimi i pronës me eksploziv" dhe "Vjedhja".

Top Channel

Kryesore

Shpallja e organizatave terroriste, DASH "i tërbuar" me Kurtin: Nuk u konsultua me ne!
08:13

Rinumërimi i votave për Kuçovën/ Përplasje në KQZ, Maliqi- Sekretarit të Përgjithshëm: Rrugaç, hajdut
10:24

Digjet apartamenti në një pallat në Shkodër, dëme materiale
09:02

Mediat e huaja: Shqipëria bum i madh turistik, ka plazhe që të lënë pa frymë
09:43

Temperaturat deri në 34 gradë C! Parashikimi i motit për këtë të premte
08:00

Më të lexuarat

Hoqi dhëmballën e infektuar, operohet në gryké 20-vjeçari! Mori dhe Hepatitin C

Vrasje e dyfishtë në Dukagjin, viktimat babë e bir

Foto 'e pafajshme' familjare që po tmerron shikuesit e vëmendshëm (imazhet)

Shkencëtarët prodhojnë simulimin më realist të një lufte bërthamore! Pasojat katastrofike mbi Tokën dhe njerëzimin të një përplasje titanësh SHBA-Rusi (Video)

Bankierja ruse 28 vjeçare bie për vdekje nga dritarja e apartamentit në Moskë (fotot)

"Polici i shezlongut" sekuestron peshqirët për të ndaluar pushuesit që t'i rezervojnë ato! Shembulli vjen nga Spanja

6 ushqime të pasura me kolinë, lënda ushqyese për shëndetin e trurit

U arratisën nga Rusia, Lukashenko "strehon" Wagner! Vendasit të tmerruar, zbulohet vendndodhja e kampit në Bjellorusi

Turkmenistani komunist inauguron qytetin e ri në nder të ish-diktatorit (fotot)

45 të arrestuarit me autobus turistik drejt Tiranës/ Karamuço ngre alarmin: Rasti i pazakontë, duheshin minimalisht 90 policë

Aktualitet »

Kumbaro në Sarandë: Dyfishohen kapacitetet e pastrimit në vijën bregdetare
30/06 10:34

Rinumërimi i votave për Kuçovën/ Përplasje në KQZ, Maliqi- Sekretarit të Përgjithshëm: Rrugaç, hajdut
30/06 10:24

Ndërron jetë 20-vjeçari në Korçë, shkak dyshohet arresti kardiak
30/06 10:11

Mediat e huaja: Shqipëria bum i madh turistik, ka plazhe që të lënë pa frymë
30/06 09:43

Arrestohet një person dhe dy të tjerë po hetohen në gjendje të lirë për ndërtime pa leje në Kukës
30/06 09:23

Fier/ Në pranga dy shtetas dhe dy të tjerë në kërkim për vepra të ndryshme penale
30/06 09:14

Kryesore »

Rinumërimi i votave për Kuçovën/ Përplasje në KQZ, Maliqi- Sekretarit të Përgjithshëm: Rrugaç, hajdut
30/06 10:24

Ndërron jetë 20-vjeçari në Korçë, shkak dyshohet arresti kardiak
30/06 10:11

Ukraina: Forcat ruse kanë filluar të largohen nga termocentrali më i madh bërthamor në Evropë
30/06 09:43

Digjet apartamenti në një pallat në Shkodër, dëme materiale
30/06 09:02

Me not nga kanali i Otrantos drejt Vlorës, Eva Buzo: Ky sport më ndihmon në punën time si avokate
30/06 08:34

Shpallja e organizatave terroriste, DASH "i tërbuar" me Kurtin: Nuk u konsultua me ne!
30/06 08:13

Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

Video »

Top News – Kërcënuan me tritol një person në Shkodër/ Identifikohen autorët, shpallen në kërkim

Top News-'Nuk është kurrë vonë'/Supermodelja 53 vjeçare sjell në jetë fëmijën e dytë

Edicioni Informativ, 29 Qershor 2023, Ora 19:30

Edicioni Informativ, 29 Qershor 2023, Ora 12:00 – Top Channel Albania – News

Top Channel/ Kosova "sfidon" Perëndimin, shpall organizata terrioriste dy grupime në veri të vendit!



Top News – Nuk mban dot lotët / Kim Kardashian kujton martesën e dështuar

© Top Channel 2001 - 2023 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.